

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit të Pavarur

**Shoqëria ABI INVEST Sh.a**

më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

# Përmbajtja

## Faqe

Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet Neto	3
Pasqyra e Flukseve të Parasë	4
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	5-15

# Raporti i Audituesit të Pavarur

## Për aksionarin e "ABI Invest sh.a",

### *Opinionit*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "ABI Invest sh.a." (këtu e më poshtë referuar "Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### *Bazat për Opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### *Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurën auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurën të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.


**Grant Thornton sh.p.k.**

Tiranë, Shqipëri

30 Prill 2024

*Grant Thornton shpk*



*Ergona Isufi*  


Shoqëria ABI Invest Sh.a  
Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023  
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
		Lekë	Lekë
<b>Aktivët</b>			
Aktive afatgjata jo materiale	7	2,630,959	4,891,960
Investime Financiare VDATGJ		19,913,242	19,753,629
Mjetet monetare dhe të ngjashme me to	8	3,793,724	3,001,898
Aktive të Tjera		866,642	1,082,635
Shpenzime të parapaguara		213,810	-
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>27,418,377</b>	<b>28,730,122</b>
<b>Detyrimet</b>			
Detyrime të tjera	9	533,010	605,436
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>533,010</b>	<b>605,436</b>
<b>Kapitali</b>			
Kapitali aksionar	10	45,000,000	45,000,000
Rezerve Rivleresimi		(2,574)	(154,866)
Fitimi (humbja) e mbartur		(16,720,447)	(13,950,656)
Fitimi (humbja) e periudhes		(1,391,612)	(3,114,996)
<b>Totali kapitalit</b>		<b>26,885,367</b>	<b>28,124,687</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>		<b>27,418,377</b>	<b>28,384,918</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 15, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqëria "ABI Invest Sh.a", më 19 prill 2024 dhe janë firmosur nga:

Administratori i Përgjithshëm  
Niko Kotonika



Shoqëria ABI Invest Sh.a

**Pasqyra e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023**

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	Per vitin e mbyllur më	Per vitin e mbyllur më
	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
	Lekë	Lekë
Të ardhura nga interesat	652,737	268,177
<b>Të ardhura nga interesat, neto</b>	<b>652,737</b>	<b>268,177</b>
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	11 10,100,488	8,666,131
Shpenzime për tarifa dhe komisione	11 (127,873)	(116,353)
<b>Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto</b>	<b>9,972,615</b>	<b>8,549,778</b>
Fitim/humbje nga kurset e këmbimit	(462,302)	(109,649)
<b>Të ardhura të tjera, neto</b>	<b>(462,302)</b>	<b>(109,649)</b>
Shpenzime personeli	12 (6,669,841)	(6,082,386)
Shpenzime administrative	13 (2,623,820)	(3,134,710)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(2,261,001)	(2,261,002)
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>(11,554,662)</b>	<b>(11,478,098)</b>
<b>Humbja para tatim fitimit</b>	<b>(1,391,612)</b>	<b>(2,769,791)</b>
Shpenzimi i tatim fitimit	-	-
<b>Humbje neto e periudhës</b>	<b>(1,391,612)</b>	<b>(2,769,791)</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>	<b>2,574</b>	<b>154,866</b>
<b>Humbje të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën, neto</b>	<b>(1,389,038)</b>	<b>(2,614,925)</b>

Pasqyra e performancës dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 15, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Shoqëria ABI Invest Sh.a

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023**

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	Humbja e akumuluar	Totali
	Lekë	Lekë	Lekë	Lekë
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>45,000,000</b>	<b>24,608</b>	<b>(13,950,656)</b>	<b>31,073,952</b>
Humbja e periudhës	-	-	(2,769,791)	(2,769,791)
Ndryshimi në zhvlerësimin e letrave me vlerë		(179,474)		
<b>Totali i të ardhurave/ (humbjeve) gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>(179,474)</b>	<b>(2,769,791)</b>	<b>(2,769,791)</b>
<b>Veprime me aksionarët, të regjistruara direkt në kapital</b>				
Kontribute të aksionarëve (shënimi 10)	-	-	-	-
<b>Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>45,000,000</b>	<b>(154,866)</b>	<b>(16,720,447)</b>	<b>28,124,687</b>
Humbja e periudhës	-		(1,391,612)	(1,391,612)
Ndryshimi në zhvlerësimin e letrave me vlerë	-	152,292		152,292
<b>Totali i të ardhurave/ (humbjeve) gjithëpërfshirëse</b>	<b>-</b>	<b>152,292</b>	<b>(1,391,612)</b>	<b>(1,239,320)</b>
<b>Veprime me aksionarët, të regjistruara direkt në kapital</b>				
Kontribute të aksionarëve (shënimi 10)	-	-	-	-
<b>Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>45,000,000</b>	<b>(2,574)</b>	<b>(18,112,059)</b>	<b>26,885,367</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 15, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



**Pasqyra e Flukseve Monetare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023**

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënime	Per vitin e mbyllur	Per vitin e mbyllur
	më 31 dhjetor 2023	më 31 dhjetor 2022
	Lekë	Lekë
<b>Humbje para tatim fitimit</b>		
<b>Rregullimet për:</b>		
Shpenzime të tjera	(1,391,612)	(2,769,791)
	-	(2,769,791)
<b>Ndryshimet në:</b>		
Rritje në aktive të tjera	8 2,263,185	1,497,638
Rritje në detyrime të tjera	9 (72,426)	(335,725)
<b>Flukset e parasë të gjeneruara nga aktiviteti operativ</b>	<b>799,147</b>	<b>(1,607,878)</b>
<b>Flukset e paraseë nga veprimtaritë Investuese</b>		
Blerje neto te investimeve ne letra me vlere te vendosjes	159,613	3,246,123
Shitje e investimeve Financiare - VDATGJ	(152,292)	(179,474)
<b>Flukset e parasë te gjeneruara nga veprimtarite finvestuese</b>	<b>(7,321)</b>	<b>3,066,649</b>
<b>Flukset e parasë nga veprimtaritë financuese</b>		
Rritja e kapitalit aksionar	10 -	-
<b>Flukset e parasë të gjeneruara nga veprimtaritë financuese</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Rënia/ (rritja) në mjetet monetare dhe ekuivalentet</b>	<b>791,826</b>	<b>1,458,771</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentë me 01 janar 2022</b>	<b>7 3,001,898</b>	<b>1,543,127</b>
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentë me 31 dhjetor 2023</b>	<b>7 3,793,724</b>	<b>3,001,898</b>

Pasqyra e flukseve të parasë duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 15 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Shoqëria ABI Invest Sh.a

**Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023  
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe**

## **1. Informacion i Përgjithshëm**

ABI INVEST sh.a. është një institucion financiar i regjistruar si Shoqëri Administruese e Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive bazuar në ligjin 56/2020, datë 30.04.2020.

Aktiviteti i Shoqërisë i nënshtrohet Ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" hyrë në fuqi më 20 qershor 2020 (duke shfuqizuar Ligjin nr. 10 198 datë 10.12.2009 dhe çdo akt tjetër që bie ndesh me të), Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", si dhe është në përputhje me të gjitha aktet nën-ligjore të aprovuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

Shoqëria është regjistruar si Shoqëri aksionare në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër regjistrimi (NUIS) L92424002L më 24 dhjetor 2019 dhe është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me datë 27.02.2020. Fondi i parë i licensuar i Shoqërisë është "ABI EIA" si sipërmarrje e investimeve kolektive me vendimin nr. 203 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare më datë 29 dhjetor 2020. . Fondet ABI FLEX EURO dhe ABI FLEX USD janë liçencuar nga Autoriteti me vendimet nr 110 dhe 112 datë 30.06.2021.

Selia Qendrore e Shoqërisë "ABI INVEST sh.a." është: Rruga e Kavajës, ndërtesa nr.27, Hyrja 1. Kati II, Njësia Bashkiake 10, Kodë Postar 1001.

Shoqëria zotërohet 100% nga "Banka Amerikane e Investimeve sh.a." ("Mëma") që nga data e themelimit të saj. Shoqëria "ABI Invest sh.a." funksionon si Shoqëri aksionare me sistem administrimi me një nivel.

Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2023 është 4 (katër) (2022: 3).

**Drejtimesit dhe administrimi i shoqërisë më 31 dhjetor 2023 përbëhet si më poshtë:**

### **Keshilli i Administrimit**

Anetar - Armand Muharremi  
Anetar - Brikena Hoxha  
Anetar - Teuta Çinari  
Anetar - Redi Hakani  
Administrator – Niko Kotonika

## **2. Baza e Përgatitjes**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK"). Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë të miratuara nga Drejtimi i Shoqërisë më datë 26 prill 2024. Shoqëria "Tranzit sh.p.k." përgatit pasqyrat e konsoliduara për të gjithë grupin duke përfshirë "Bankën Amerikane të Investimeve sh.a.", "ABI Invest sh.a." dhe "ABI Broker sh.a."

### **2.2 Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

### **2.3 Monedha funksionale dhe ajo e prezantimit**

Keto pasqyra financiare të Shoqërisë janë paraqitur në Lekë Shqiptar (Leke), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.4 Parimi i vijimësisë**

Keto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë. Menaxhimi i Shoqërisë ka bërë vlerësimin e aftësisë së saj për të vijuar biznesin në bazë të parimit të vijimësisë, dhe është i kënaqur që ka burime për të vazhduar në biznes për të ardhmen e parashikueshme nga mbështetja e siguruar nga Mëma për fillimin dhe zgjerimin e aktivitetit. Menaxhimi nuk ka identifikuar pasiguri materiale që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar veprimtarinë dhe për këtë arsye përgatitja e pasqyrave financiare në bazë të parimit të vijimësisë mbetet e përshtatshme

## **2. Bazat e Përgatitjes (Vazhdim)**

### **2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-te kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe vlerave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën ndodh rishikimi dhe në periudhat e ardhshme që afektohen/preken nga këto ndryshime. Drejtimi beson se vlerësimet dhe supozimet bazë janë të duhura dhe se, si rrjedhojë, pasqyrat financiare paraqesin saktë pozicionin dhe rezultatin financiar. Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare.

## **3. Ndryshimet në politikat kontabël**

### **3.1 Standardet dhe amendimet e reja ose të ndryshuara**

#### **3.1.1 Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara**

Standardet e ndryshuara në vijim hyjnë në fuqi më 1 janar 2023, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material tek Shoqëria:

**3.1.2 SNRF 17 "Kontratat e sigurimit"** (lëshuar më 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023). Ndryshimet në SNRF 17 dhe një ndryshim në SNRF 4 (publikuar më 25 qershor 2020 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023).

#### **3.1.3 Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara (Vazhdim)**

- Opsioni i tranzicionit për siguresit që zbatojnë SNRF 17 – Ndryshimet në SNRF 17 (publikuar më 9 dhjetor 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- Ndryshime në SNK 1 dhe Deklarata e praktikës SNRF 2: Dhënia e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (publikuar më 12 shkurt 2021 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).

#### **3.1.4 Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara**

- Ndryshime në SNK 8: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (botuar më 12 shkurt 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023).
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm – Ndryshimet në SNK 12 (publikuar më 7 maj 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023)
- Ndryshime në SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Reforma Ndërkombëtare Tatimore – Rregullat Model Shtylla e Dytë (botuar më 23 maj 2023).

#### **3.1.5 Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara**

Një numër i standardeve të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria planifikon të zbatojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

- Ndryshimet në SNRF 16 Qiratë: Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe kthim me qira (leaseback) (lëshuar më 22 shtator 2022 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024).

### **3. Ndryshimet në politikat kontabël (vazhdim)**

#### **3.2 Standardet dhe amendimet e reja ose të ndryshuara**

- Klasifikimi i detyrimeve si rrjedhëse ose afatgjata – Ndryshime në SNK 1 (fillimisht i publikuar më 23 janar 2020 dhe i ndryshuar më pas më 15 korrik 2020 dhe 31 tetor 2022, përfundimisht në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024).
- Ndryshime në SNK 7 Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese: Marrëveshjet financiare të furnizuesit (Lëshuar më 25 maj 2023).
- SNRF 14, Llogaritë e Shtyra Rregullatore (lëshuar më 30 janar 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- Shtjta ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët – Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).

Këto standarde ose ndryshimet në standardet ekzistuese nuk janë miratuar më parë nga Shoqëria. Drejtimi parashikon që të gjitha prononcimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë paraqitur pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

### **4. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Shoqëria, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

#### **4.1 Transaksionet ne monedhe te huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetar është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejt rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejt. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Shoqëria nuk ka transaksione në monedhë të huaj për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023.

Kurset e këmbimit të përdorura në konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj janë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Euro/Lekë	103.88	114.23
USD/Lekë	93.94	107.05

#### **4.2 Interesat**

Sipas SNRF 9, të ardhurat nga interesat regjistrohen duke përdorur metodën e normës efektive të interesit ("NEI") për të gjithë instrumentet financiare. Norma efektive e interesit është norma, me të cilën skontohej egzaktesisht pagesat e vlerësuara të ardhshme të mjeteve monetare ose arkëtimet përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar (ose kur është e përshtatshme, për periudhën më të shkurtër), duke arritur në vlerën kontabël neto të aktivitetit financiar.

Kur një aktiv financiar zhvlerësohet, Shoqëria i përlogarit të ardhurat nga interesat duke aplikuar normën efektive të interesit mbi vlerën neto të aktivitetit financiar. Shoqëria nuk ka aktive financiare të zhvlerësuara.

#### **4.3 Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e fitim humbjeve të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në të ardhura të tjera përmblendhëse. Shoqëria nuk ka tatim mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

#### **4.Politikat Kontabel (Vazhdim)**

##### **4.4 Instrumentet Financiare**

###### **4.4.1 Data e njohjes**

Aktivet dhe detyrimet financiare fillimisht njihen në datën e tregtimit që është data në të cilën shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin mënyrën standarde të tregtimit; blerje ose shitje e aktiveve financiare që kërkojnë dorëzimin e aktiveve brenda një afati kohor, përgjithësisht të përcaktuar me rregullore apo konvente në treg.

###### **4.4.2 Njohja fillestare e instrumenteve financiare**

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga termat e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për të menaxhuar këto instrumente. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë për të cilat kostot e transaksionit shtohen apo zbriten nga kjo vlerë. Llogaritë e arkëtueshme maten me çmimin e transaksionit. Në rastet kur vlera e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, Shoqëria regjistron fitimin ose humbjen e Ditës së parë.

###### **4.4.3 Përlllogaritja e humbjeve të pritshme të kredisë HPK-se**

Shoqëria ka vetëm llogari rrjedhëse me Mëmën për të cilat nuk pret të ketë humbje të pritshme të kredisë materiale

##### **4.5 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj përfshijnë llogari rrjedhëse në bankë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Shoqëria për menaxhimin e angazhimeve afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e të pozicionit financiar.

###### **4.5.1 Matja e vlerës së drejtë**

'Vlera e drejtë' është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrës në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Shoqëria ka akses në atë datë.

Për të treguar se si janë nxjerre vlerat e drejta, instrumentet financiare janë riklasifikuar bazuar në një hierarki të teknikave të vlerësimit, siç përmbledhet më poshtë:

- **Niveli 1:** Ato ku inputet e përdorura në vlerësim janë çmimet e kuotuar të parregulluara në tregjet aktive për një instrument identik në të cilat Shoqëria ka qasje në datën e matjes.
- **Niveli 2:** Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur: çmimet e kuotuar të tregut në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak se aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjithë inputet e rëndësishme janë direkt ose indirekt të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.
- **Niveli 3:** Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet ku teknikat e vlerësimi përfshijnë inpute të cilat nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet e pavëzhgueshme mund të ketë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme, ku rregullime të rëndësishme të pavëzhgueshme ose supozime janë të nevojshme për të reflektuar diferencat midis instrumentev

**5. Menaxhimi i Riskut Financiar**

Aktiviteti i Shoqërisë është i ekspozuar kundrejt disa risqeve financiare si: risku i likuiditetit, risku i kredisë, risku i normës së interesit dhe risku i kursit të këmbimit, vlerësimi i të cilave është paraqitur më poshtë. Menaxhimi i riskut financiar drejtohet dhe fokusohet në paparashikueshmërinë e tregut financiar dhe synon të minimizojë efektet potenciale të papëlqyeshme. Menaxhimi i riskut financiar ndërmerret nga departamenti i financës i kompanisë sipas politikave të aprovuara.

(i) *Risku nga kursi i këmbimit*

Reziku ndaj riskut të kursit të këmbimit vjen si rezultat i ekspozimit të Shoqërisë ndaj monedha të ndryshme. Shoqëria nuk ka aktive ose detyrime financiare në monedhë të huaj, dhe si rrjedhojë, nuk ka ndjeshmëri ndaj ndryshimeve të mundshme të kurseve të këmbimit.

Tabela e mëposhtme tregon një analizë të aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë më 31 Dhjetor 2023 sipas monedhave përkatëse:

	Leke	USD	Eur	Totali
<b>31 dhjetor 2023</b>				
Mjete Monetare	208,360	1,591,145	1,994,219	3,793,724
Letrat me vlerë të drejta nepermjet te ardhurave të tjera gjithëpërshirëse	19,913,242	-	-	19,913,242
Aktive të tjera	1,080,452	-	-	1,080,452
<b>Totali</b>	<b>21,202,054</b>	<b>1,591,145</b>	<b>1,994,219</b>	<b>24,787,418</b>
Detyrime të tjera	533,010	-	-	533,010
<b>Totali</b>	<b>533,010</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>533,010</b>
<b>Pozicioni neto më 31 dhjetor 2023</b>	<b>20,669,044</b>	<b>1,591,145</b>	<b>1,994,219</b>	<b>24,254,408</b>
<b>31 dhjetor 2022</b>				
Mjete Monetare	453,554	606,341	1,942,004	3,001,898
Letrat me vlerë të drejta nepermjet te ardhurave të tjera gjithëpërshirëse	19,753,629	-	-	19,753,629
Aktive të tjera	1,082,635	-	-	1,082,635
<b>Totali</b>	<b>21,289,818</b>	<b>606,341</b>	<b>1,942,004</b>	<b>23,838,162</b>
Detyrime të tjera	605,436	-	-	605,436
<b>Totali</b>	<b>605,436</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>605,436</b>
<b>Pozicioni neto më 31 dhjetor 2022</b>	<b>20,684,382</b>	<b>606,341</b>	<b>1,942,004</b>	<b>23,232,726</b>

**5. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)**(ii) *Risku i kreditit*

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë nëse klientët ose palët e tjera një instrument financiar nuk arrijnë të përmbushin detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Shoqëria ka vetëm mjete monetare me Mëmën dhe ekspozimi ndaj këtij rreziku është jo material.

Tabela e mëposhtme jep informacion për cilësinë e kreditit të aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuara dhe vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe, për aktivet financiare, vlerat e paraqitura në tabelë paraqesin vlerën e mbetur bruto.

	Më 31 dhjetor 2023				Më 31 dhjetor 2022	
	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	POCI	Totali	Totali
<b>Mjete Monetare</b>						
Risk i ulet	3,793,724	-	-	-	3,793,724	3,001,898
Pakesuar me zhvleresimin	-	-	-	-	-	-
<b>Vlera e mbartur</b>	<b>3,793,724</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>3,793,724</b>	<b>3,001,898</b>

	Më 31 dhjetor 2023				Më 31 dhjetor 2022	
	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	POCI	Totali	Totali
<b>Letrat me vlerë- VDATGJ</b>						
Risk i ulet (vlera bruto)	19,915,816	-	-	-	19,915,816	19,908,495
Pakesuar/shtuar me rivleresimin	(2,574)	-	-	-	(2,574)	(154,866)
<b>Vlera e mbartur</b>	<b>19,913,242</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>19,913,242</b>	<b>19,753,629</b>

	Më 31 dhjetor 2023				Më 31 dhjetor 2022	
	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	POCI	Totali	Totali
<b>Aktive të tjera</b>						
Risk i ulet	1,080,452	-	-	-	1,080,452	1,082,635
Pakesuar me zhvleresimin	-	-	-	-	-	-
<b>Vlera e mbartur</b>	<b>1,080,452</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,080,452</b>	<b>1,082,635</b>

(iii) *Risku i normes së interesit*

Të ardhurat e shoqërisë dhe fluksi monetar operues janë thellësisht të pavarura nga ndryshimet në treg të normës së interesit. Kompania nuk ka instrumente që ndikohen në mënyre domethënëse nga përqindja e interesit.

**5. Menaxhimi i Riskut Financiar (vazhdim)****(iv) Rreziku i Likuiditetit**

Rreziku i likuiditetit përcaktohet si rreziku që një njësi ekonomike do të përballet me vështirësi për të përmbushur detyrimet që lidhen me detyrimet financiare. Shoqëria nuk ka detyrime financiare dhe rrjedhimisht nuk është e ekspozuar ndaj këtij rreziku.

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2023 dhe më 31 dhjetor 2022 sipas maturitetit të mbetur duke marrë në konsideratë fluksin e parave të paskontuara sipas maturitetit kontraktual dhe duke reflektuar supozime për ri-pagesa të hershme apo duke përdorur të dhënat historike.

<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>Me pak se 6 muaj</b>	<b>Midis 6 dhe 12 muaj</b>	<b>Me shume se 1 vit</b>	<b>Totali</b>
Mjete Monetare	3,793,724	-	-	3,793,724
Letrat me vlere VDATGJ	19,913,242	-	-	19,913,242
<b>Totali</b>	<b>23,706,966</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>23,706,966</b>
Detyrime të tjera	533,010	-	-	533,010
<b>Totali</b>	<b>533,010</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>533,010</b>
<b>Hendeku i likuiditetit me 31.12.2023 Kumulativ</b>	<b>23,173,956</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>23,173,956</b>
	<b>23,173,956</b>	<b>23,173,956</b>	<b>23,173,956</b>	<b>-</b>

<b>31 dhjetor 2022</b>	<b>Me pak se 6 muaj</b>	<b>Midis 6 dhe 12 muaj</b>	<b>Me shume se 1 vit</b>	<b>Totali</b>
Mjete monetare	3,001,898	-	-	3,001,898
Letrat me vlere VDATGJ	19,753,629	-	-	19,753,629
<b>Totali</b>	<b>22,755,527</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>22,755,527</b>
Detyrime të tjera	605,436	-	-	605,436
<b>Totali</b>	<b>605,436</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>605,436</b>
<b>Hendeku i likuiditetit me 31.12.2022 Kumulativ</b>	<b>22,150,091</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>22,150,091</b>
	<b>22,150,091</b>	<b>22,150,091</b>	<b>22,150,091</b>	<b>-</b>

**6. Paraqitja dhe vleresimi i vleres se drejte**

Shoqëria ka vetem mjete monetare qe perfshijne llogari rrjedhese me Memen dhe vlere e tyre e drejte konsiderohet te jete e njejte me vleren kontabel te tyre.

Tabela e mëposhtme tregon vleren e drejte te aktiveve financiare dhe analizon ato nga hierarkia e vleres se drejte ne te cilen është klasifikuar.

	<b>Me 31 dhjetor 2023</b>			
	<b>Vlera e mbartur</b>	<b>Vlera e drejte Niveli 1</b>	<b>Vlera e drejte Niveli 2</b>	<b>Vlera e drejte Niveli 3</b>
<b>Aktive financiare</b>				
Mjete Monetare	3,793,724	-	-	3,793,724
Letrat me vlere me vlere te drejte nepermjet te ardhurave te tjera gjithepershires	19,913,242	-	19,913,242	-
<b>Detyrime financiare</b>				
Detyrime të tjera	533,010	-	-	533,010



**6. Paraqitja dhe Vlerësimi i Vlerës së Drejte (vazhdim)**

	Me 31 dhjetor 2022			
	Vlera e mbartur	Vlera e drejte Nivel 1	Vlera e drejte Nivel 2	Vlera e drejte Nivel 3
<b>Aktive financiare</b>				
Mjete Monetare	3,001,898	-	-	3,001,898
Letrat me vlerë të drejte nepërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	19,753,629	-	19,753,629	-
<b>Detyrime financiare</b>				
Detyrime të tjera	605,436			605,436

**7. Aktive Afatgjata Jo Materiale**

Aktivet afatgjata jo materiale më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 janë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
	Programe kompjuterike	Programe kompjuterike
<b>Kosto</b>		
<b>Gjëndja më 1 janar 2023</b>	<b>8,920,114</b>	<b>8,920,114</b>
Shtesa	-	-
Transferime	-	-
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>8,920,114</b>	<b>8,920,114</b>
<b>Amortizimi akumuluar</b>		
<b>Gjëndja më 1 janar 2023</b>	<b>(4,028,154)</b>	<b>(1,767,153)</b>
Shpenzimi i periudhës	(2,261,001)	(2,261,001)
Pakësime	-	-
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>(6,289,155)</b>	<b>(4,028,154)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>		
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>2,630,959</b>	<b>4,891,960</b>

**8. Investimet Financiare**

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Bono Thesari (vlera nominale)	20,000,000	20,000,000
Premium/discount	(645,414)	(334,825)
Interes i përlogaritur	561,230	243,320
Diferencë rivlerësimi	(2,574)	(154,866)
<b>Totali</b>	<b>19,913,242</b>	<b>19,753,629</b>

Investimi në Tbill AL000A3LDQZ7 është kryer në datë 30 mars 2023, me vlerë nominale 20 milion lekë, yield 3.78%.

**9. Mjetet monetare dhe te ngjashmet me to**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to për 31 dhjetor 2023 dhe më 31 dhjetor 2022 janë si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Llogari rrjedhëse me Banken Credins	43,387	9,681
Banka e Pare e Investimeve	3,266,371	1,364,729
Llogari rrjedhëse me Banken Amerikane te Investimeve	483,966	1,627,489
<b>Totali</b>	<b>3,793,724</b>	<b>3,001,898</b>

**10. Detyrime te tjera**

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022 përbëhen si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Furnitorë	-	-
Sigurime shoqerore	511,704	581,063
Tatim mbi te ardhurat per tu paguar	-	-
Tatim mbi vleren e shtuar per tu paguar	21,306	24,373
Të tjera	-	-
<b>Totali</b>	<b>533,010</b>	<b>605,436</b>

**11. Kapitali Aksionar**

Kapitali aksionar i autorizuar, i emetuar dhe i paguar plotësisht i Shoqërise më 31 dhjetor 2022 dhe më 31 dhjetor 2021 është si vijon:

Monedha	<b>Më 31 dhjetor 2023</b>			
	Nr i aksioneve	Vlera Nominale	Në monedhë origjinale	Në Lek
LEK	45,000	1,000	45,000,000	45,000,000
	<b>45,000</b>			<b>45,000,000</b>

Monedha	<b>Më 31 dhjetor 2022</b>			
	Nr i aksioneve	Vlera Nominale	Në monedhë origjinale	Në Lek
LEK	45,000	1,000	45,000,000	45,000,000
	<b>45,000</b>			<b>45,000,000</b>

**12. Te Ardhura Neto nga Tarifat dhe Komisionet**

Te ardhurat nga tarifet dhe komisionet paraqiten si ne vijim:

<b>Të ardhura nga komisionet të fituara nga shërbime që jepen përgjatë periudhës:</b>	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Tarife e administrimit te fondeve	10,100,488	8,666,131
Tarifa të tjera	-	-
<b>Të ardhura nga tarifet dhe komisionet</b>	<b>10,100,488</b>	<b>8,666,131</b>
Shërbime komisione mirembajtje llogarie	127,873	116,353
Shërbime arkëtimesh e pagesash	-	-
<b>Shpenzime për tarifa dhe komisione</b>	<b>127,873</b>	<b>116,353</b>
<b>Të ardhura neto nga tarifet dhe komisionet</b>	<b>9,972,615</b>	<b>8,549,778</b>

Shoqëria ABI Invest Sh.a

**Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**  
(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**13. Te ardhura nga Interesat**

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Amortizim Premium/skonto bono thesari	652,737	268,177
<b>Totali</b>	<b>652,737</b>	<b>268,177</b>

**14. Shpenzimet e Personelit**

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Paga dhe bonuse	5,949,563	5,391,954
Sigurimet shoqërore	720,278	690,432
<b>Totali</b>	<b>6,669,841</b>	<b>6,082,386</b>

**15. Shpenzime te Tjera Administrative**

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzime mirembajtje software	1,906,745	2,139,988
Sherbime te tjera te jashtme (Auditorët e Jashtëm)	271,527	425,709
Sherbime asistence teknike (ligjore, kontabiliteti, IT)	179,000	-
Tarifa Regjistrimi	111,801	89,645
Taksa bashkiake	74,500	74,500
Tarifa Licensimi (Web)	54,755	38,105
Të tjera	10,492	5,608
Penalite	10,000	15,000
Tarifa Administrimi	5,000	345,205
Shpenzime Marketingu	-	950
Pritje/percjellje	-	-
Kancelari	-	-
<b>Totali</b>	<b>2,623,820</b>	<b>3,134,710</b>

**16. Tatim fitimi**

Rakordimi i i shpenzimit të tatim fitimit me fitimin/(humbjen) kontabël për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
<b>Fitimi / (humbja) kontabël para tatimit</b>	<b>(1,391,612)</b>	<b>(2,769,792)</b>
Shpenzime të pazbritshme	1,170,496	1,014,112
<b>Fitimi Tatimor përpara njohjes së humbjeve të bartura</b>	<b>(221,116)</b>	<b>(1,755,680)</b>
Njohja e humbjeve të bartura	-	-
<b>Baza e tatueshme</b>	<b>(221,116)</b>	<b>(1,755,680)</b>
<b>Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat në 15%</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Shpenzimet e pazbritshme janë të detajuara si më poshtë:

	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Shpenzime te panjohura, provigjone shpenzimesh pa fatura	1,170,496	1,014,112
<b>Totali</b>	<b>1,170,496</b>	<b>1,014,112</b>
<b>Llogaritur 15%</b>	<b>175,574</b>	<b>152,117</b>

Shoqëria ABI Invest Sh.a

**Shënime Shpjeguese mbi Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**  
*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

**17. Veprime me Palet e lidhura**

Palet quhen te lidhura kur njera prej tyre ka mundesine te kontrolloje palet e tjera ose te ushtroje ndikim domethenes ne vendim-marrjen financiare dhe operacionale te tyre. Per te vleresuar çdo maredhenie te mundshme te paleve te lidhura, vemendja i eshte kushtuar thelbit te marredhenies dhe jo vetem anes ligjore te saj.

Shoqëria ka marredhenie me pale te lidhura me memen ("Banka Amerikane e Investimeve sh.a.") dhe stafin drejtues. Struktura e aksionareve te Shoqërisë me 31 dhjetor 2023 paraqitet ne shenimin 1.

Ne datat respektive te mbylljeve te raportimit, Shoqëria ka gjendjet e meposhtme me palet e lidhura:

	31 dhjetor 2023	
	Drejtuesit e shoqërisë	Banka Amerikane e Investimeve
<b>Transaksionet Aktive</b>		
Llogari rrjedhëse	-	3,793,724
<b>Detyrime</b>		
Detyrime te perlllogaritura	-	-
<b>Te ardhura</b>		
Te ardhura nga interesat	-	-
<b>Shpenzime</b>		
Sherbime asistence teknike (ligjore, kontabiliteti, IT)	-	-
Shpenzime nga tarifa dhe komisione	-	-
Shpenzime operative	-	-
<b>Pagat dhe shpërblimet për drejtimin e shoqërisë paraqiten si më poshtë:</b>		
Paga	1,328,182	
Bonuse	338,200	

	31 dhjetor 2022	
	Drejtuesit e shoqërisë	Banka Amerikane e Investimeve
<b>Transaksionet Aktive</b>		
Llogari rrjedhëse	-	3,001,898
<b>Detyrime</b>		
Detyrime te perlllogaritura	-	-
<b>Te ardhura</b>		
Te ardhura nga interesat	-	-
<b>Shpenzime</b>		
Sherbime asistence teknike (ligjore, kontabiliteti, IT)	-	-
Shpenzime nga tarifa dhe komisione	-	-
Shpenzime operative	-	-
<b>Pagat dhe shpërblimet për drejtimin e shoqërisë paraqiten si më poshtë:</b>		
Paga	2,274,818	
Bonuse	380,000	

**18. Angazhimet dhe Detyrimet e Kushtëzuara**

**Pretendime për çështje ligjore**

Më 31 dhjetor 2023, Shoqëria nuk ka çështje apo pretendime ligjore që mund të kenë impakt ne këto pasqyra financiare

**19. Ngjarje pas datës së raportimit**

Nuk ka ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime ose shpalosje shtesë në këto pasqyra financiare.